



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:083168

Datë: 30.05.2022

Numri i dokumentit: 03075732

PKR.nr.76/2022

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, me Kryetaren e Trupit gjykuese Violeta Husaj-Rugova me pjesëmarrjen e sekretares juridike Bute Ramosaj, në çështjen penale kundër të akuzuarit B. I nga fshati B K- D, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-se, i akuzuar sipas aktakuzës së PTH –Departamenti për Krime të Rënda në Pejë, PP/I.nr. 135/22 të dt. 27.04.2022, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në prezencë të Prokurores së shtetit Lumturije Vuçetaj të akuzuarit B.I si dhe mbrojtësi i tij av. Sylë Lokaj me dt. 30.05.2022 mori dhe publikisht shpalli, dhe të njëjtën ditë përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

B.I i biri i **S** dhe nënës **Z** e gjinisë **M**, i lindur me dt. ne fshatin B K- D,, i gjendjes së dobët ekonomike, posedon telefon me numër, i identifikuar në baze të letërnjoftimit me numër personal, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

Më parë e gjere me dt. 23.03.2022 rreth orës 15:00 në fsh. B K-D, në kundërshtim neni 4 par 1 nen par 1.1 pika 1.1.9 me Ligjin për armë 05/L-022 ka mbajtur në pronësi kontroll posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armën, pistoletën me gas e llojit G.P cal 4.5 mm, me nr. serik ...-...-...-..., si armë të ndaluara për përdorim për civilët, si dhe 14 fishekë të kalibrit 9 mm, në atë mënyrë që policia gjatë zbatimit të urdhrin verbal për bastisje të shtëpisë së të pandehurit, të njëjtit në dhomën e gjumit i gjejnë dhe sekuestrojnë armën e cekur si më lart.

-me çka ka kryer veprën penale ‘‘Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve’’, nga neni 366, par. 1, të KPRK-së.

Andaj , gjykata konform nenit 7,17 par.1,38,39,40,43, nenit 69, 70, nenit 366 par.1 , te KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPRK-së, të akuzuarin :

E GJYKON

Për veprën penale si në dispozitivin të cekur më lartë, me dënim me gjobë në lartësi prej 300€ (treqind euro), të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 3 (tre) muajve nga data e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nëse i akuzuari i lartcekur dënimin nuk e paguan në afat të caktuar, atëherë dënimin me gjobë gjykata do ta zëvendësoi me dënim burgu duke iu llogaritur një ditë burgim për çdo 20 € (njëzet euro të gjobës).

Të akuzuarit i konfiskohen: arma me gas e llojit G.Pcal 4.5 mm, me nr. serik-...-.....-..., si dhe 14 fishekë te kalibrit 9 mm.

I akuzuari obligohet që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20€(njëzet euro), si dhe shumën prej 50€ (pesëdhjetë euro) në emër të kompensimit të viktimave, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti për Krime të Rënda, ka ngrit aktakuzë PP/I.nr. 135/22 të dt. 27.04.2022, kundër te akuzuarit B.I nga fshati B K- D për shkak veprës penale mbajtja ne pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim te paautorizuar te armëve nga neni 366 par. 1 te KPRK-se.

Para se te lexoi aktakuzën prokurorja e shtetit bënë plotësimin e dispozitivit te aktakuzës dhe a të në rreshtin e 2 i cili duhet të jetë në kundërshtim me nenin 4 par 1 nen par 1.1, pika 1.1.9 si armë te ndaluara për përdorim për civilët, po ashtu ne rreshtin e 3 pas fjalës pistoletë shtohet fjala me gas, gjersa pjesa tjetër mbetet e pa ndryshuar.

Pas leximit të aktakuzës së korrigjuar nga ana e Prokurorit të shtetit në seancën e shqyrtimit fillestar, gjykata është bindur se i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën dhe të drejtat e tij dhe të akuzuarit i ka dhënë mundësinë që të deklarohej për fajësinë.

Në këtë rast gjykata ka udhëzuar të akuzuarin për rëndësinë dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe i akuzuari B.I ka deklaruar se i ka kuptuar pasojat e pranimit të fajësisë dhe se e pranon fajësinë për veprën penale që i vihet në barrë dhe nuk do ta përsëris më.

Prokurorja e shtetit ka deklaruar: “ pajtohem me pranimin e fajësisë meqenëse një pranim i tillë është i bazuar në shkresat e lëndës, dhe pranimin e fajësisë e ka bërë edhe në prokurori, kështu që i propozoj gjykatës që të njëjtën ta aprovoj”.

Mbrojtësi i të akuzuarit av. S. L. ka deklaruar: “pajtohem me pranimin e fajësisë, i pandehuri pranimin e fajësisë e ka bërë pa presion nga askush pas këshillave të mjaftueshme, andaj i propozoi gjykatës që ta pranoi fajësinë, i propozoi gjykatës që ti shqiptoi një dënim minimale me gjobe duke marrë parasysh se ka një gjendje shumë të dobët ekonomike”.

Në vijim gjykata duke shqyrtuar fajësinë nga ana e të akuzuarit vlerësoi se pranimi i fajësisë paraqet shprehje të lirë të vullnetit të akuzuarit pasi që i njëjti i ka kuptuar pasojat dhe përparësitë e pranimit të fajësisë dhe se pranimi i fajësisë ka mbështetje në provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Duke pasur parasysh të lartcekurat gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe ka vërtetuar se nuk ekziston ndonjë rrethanë për hudhje të aktakuzës konform nenit 253 të KPPRK-së, se janë plotësuar kushtet nga neni 248 të KPPRK-së, atëherë në këtë çështje nuk është zbatuar procedura e provave.

Gjykata e ka shpall fajtor të akuzuarin bazuar në pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe bazuar në provat që gjenden në shkresat e lëndës siç janë: raporti i policit I. S. me nr....-...-... te dt. 23.03.2022, vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve me nr. ...-...-... e dt. 23.03.2022, fotot e vendit të ngjarjes si dhe fotot armës, si dhe shkresat e tjera të lëndës.

Duke vendosur mbi vendimin mbi dënim gjykata i vlerësoj të gjitha rrethanat për dënimin konform nenit 69 dhe 70 të KPRK-së. Si rrethana lehtësuese gjykata vlerësoj se i akuzuari e ka pranuar fajësinë në shqyrtim fillestarë, pendimin e tij dhe premtimin se nuk do të përsëriten veprime të tilla, gjendjen e dobët ekonomike. Rrethana rënduese nuk pati.

Andaj gjykata duke u gjendur para këtyre rrethanave vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke konsideruar se dënimi i shqiptuar është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë. Gjykata është bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit, siç është pengimi i të akuzuarit në kryerjen e veprës penale në të ardhmen si dhe në preventivën tjetër për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale, gjithnjë duke u bazuar në nenit 38 të KPRK-së.

Vendimi mbi konfiskimin u mor konform nenit 366 par.3 të KPRK-së të si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi pagesën e paushallit gjyqësor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi gjykata e mori konform nenit 450 të KPPRK-së.

Vendimi mbi kompensimin e viktimave të krimit u mor konform nenit 39 par.1,2,3 nën par. 3.1 të Ligjit për kompensim të viktimave.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 365 të KPPK-së.

**GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA,**

2022:083168, 30.05.2022

Kryetarja e trupit gjykues

Violeta Husaj Rugova

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.